



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:178662 C. nr. 2745/2023  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05706760

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, me gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve H.Ç., I.Y. dhe I.M. të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqësojnë D.Sh. dhe N.M. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën e përfaqëson me autorizim V.I.Xh. përfaqësuese ligjore pran të paditurës, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,112.84 euro, jashtë seance, me datë 20 maj 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve H.Ç., I.Y. dhe I.M. të gjithë nga Prizreni, DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditëset të kompensohen në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

• **Paditësja H.Ç.**

1. Për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.64 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.72 euro;
3. Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro; apo shumën e përgjithshme prej 697.84 euro.

• **Paditësja I.Y.**

- Për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.64 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.72 euro;
- Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro; apo shumën e përgjithshme prej 697.84 euro.

• **Paditësi I.M.**

- Për periudhën kohore Shtator - Dhjetor 2020 në shumën prej 3.64 euro;
- Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.72 euro;
- Për periudhën kohore Janar – 21 Nëntor 2022, në shumën prej 522.48 euro; apo shumën e përgjithshme prej 697.84 euro.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, që paditësve të ua paguaj shumën e përgjithshme prej 2,093.52 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të

rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (22.08.2023), e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën prej 239.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesë padisë, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën I të këtij dispozitivi.

### A r s y e t i m

Paditësit H.Ç., I.Y. dhe I.M. të gjithë nga Prizreni, në këtë gjykatë me datë 22.08.2023, përmes të autorizuarve të tyre, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Emin Duraku” me seli në Prizren, ku të njëjtet kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë, e referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në nenin 35 par.10, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2020, 2021 dhe 2022, paditësve ju takon shuma në lartësi prej 2,112.84 euro. Po ashtu kanë theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar.

Të autorizuarit e paditësve, përmes parashtresës së datës 15.11.2023 ka kërkuar që paditësve t'i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga për vitin Janar –Dhjetor 2020, deri më Janar 2022-21 Nëntor 2022, dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2020 në 0.2%, për vitin 2021 3.4% dhe për vitin 2022 në 11.6%, në pagën e kërkuar prej 421.00 euro e në shumë totale prej 2.112, 84 euro të gjitha këto me kamat ligjore prej 8 % nga data 01.01.2020 e deri në pagesën definitive, e në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 05.01.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditësës se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtës së saj pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Ka theksuar se në bazë të

njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit prej vitit 2019 është parashkruar sipas nenit 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve sepse kanë kaluar mbi 3 vite. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësit të lëshuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU "Emin Duraku" në Prizren, si mësimdhënës. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësve. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *"Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të"*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *"Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë"*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *"Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve"* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve u takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësen H.Ç.

- Për periudhën Shtator - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 3.64 euro ( $421 \cdot 0.2\% = 0.84 \cdot 4 \text{ muaj} = 3.36 \text{ euro}$ ) si dhe periudha 10 ditë të muajit gusht është 0.28 euro sipas ( $0.84/30 = 0.28 \cdot 10 \text{ ditë} = 0.28 \text{ euro}$ ) =  $3.36 + 0,28 = 3.64 \text{ euro}$ ).

- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ( $421 \times 3.4\% = 14.31 \times 12 = 171.72$  euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 488.83 euro ( $421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 10 \text{ muaj} = 488.36$  euro) +21 ditë  $1,62 = 34.18$  euro.

#### Për paditësen I.Y.

- Për periudhën Shtator - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 3.64 euro ( $421 \times 0.2\% = 0.84 \times 4 \text{ muaj} = 3.36$  euro) si dhe periudha 10 ditë të muajit gusht është 0.28 euro sipas ( $0.84/30 = 0.28 \times 10 \text{ ditë} = 0.28$  euro) =  $3.36 + 0,28 = 3.64$  euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ( $421 \times 3.4\% = 14.31 \times 12 = 171.72$  euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 488.83 euro ( $421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 10 \text{ muaj} = 488.36$  euro) +21 ditë  $1,62 = 34.18$  euro.

#### Për paditësin I.M.

- Për periudhën Shtator - Dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 3.64 euro ( $421 \times 0.2\% = 0.84 \times 4 \text{ muaj} = 3.36$  euro) si dhe periudha 10 ditë të muajit gusht është 0.28 euro sipas ( $0.84/30 = 0.28 \times 10 \text{ ditë} = 0.28$  euro) =  $3.36 + 0,28 = 3.64$  euro).
- Për periudhën Janar - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 171.72 euro ( $421 \times 3.4\% = 14.31 \times 12 = 171.72$  euro).
- Për periudhën Janar 2022-21 Nëntor 2022 gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 488.83 euro ( $421.00 \times 11.6\% = 48.83 \times 10 \text{ muaj} = 488.36$  euro) +21 ditë  $1,62 = 34.18$  euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 22.08.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2020 deri më datë 21.08.2020. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 7 muaj e 21 ditë apo në shumën prej 6.50 euro, ndërsa paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë dhe atë më datë 22.08.2023.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kumatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë në këtë gjykatë (22.08.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të tjera të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 208.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 31.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 239.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
C. nr. 2745/2023, datë 20 maj 2024

G j y q t a r i  
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.